



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija za Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

DATË/A:	29.03.2017
REFERENC-Ë:	38.03.17
PËR/ZA/TO:	Z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
CC:	Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Kuvendi i Republikës së Kosovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Idriz Blakaj / Drejtor - AMKMK
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti Vjetor i AMKMK-së

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Përmes kësaj shkrese iu dërgojmë Raportin Vjetor të AMKMK-së për vitin 2016.

Bashkëngjitur me këtë Raport Vjetor do të keni:

- Raportin Financiar të AMKMK-së për vitin 2016;
- Planin e punës së AMKMK-së për vitin 2017.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija za Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

Raporti Vjetor i Punës së AMKMK-së
për vitin 2016

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

1. Përmbledhje Ekzekutive

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës është themeluar në vitin 2013 pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/L-146 të AMKMK-së, pas publikimit të GZRK/Nr.9/ datë 26.04.2013.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale është Institucion i pavarur, që merret me planifikimin, projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Agjencia për punën e vet i raporton një herë në vit Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në këtë aspekt, AMKMK do të paraqesë raportin vjetor përkitazi me të gjitha aktivitetet relevante dhe lidhur me zbatimin e Ligjit të AMKMK-së.

Agjencia mbikëqyrë, përkujdeset, menaxhon aktivitete të ndryshme lidhur me Komplekset dhe Memorialet, duke nxjerrë vendime, rekomandime, duke hartuar Akte nënligjore dhe nxjerrë Memorandume dhe Marrëveshje Bashkëpunimi në koordinim me nivelin lokal dhe qendror.

Në këtë raport po i përmendim objektivat kryesore dhe më të rëndësishme që janë: korniza ligjore, buxheti i AMKMK-së, rritja e numrit të stafit të Agjencisë.

Arritjet e AMKMK-së për vitin e raportimit 2016 janë: përmbushja e infrastrukturës ligjore sidomos nxjerrja e legjislacionit sekondar në tërësi, realizimi i objektivave të disa projekteve duke pasur parasysh buxhetin e vogël.

Sfidat në të ardhmen mbeten rritja e buxhetit të AMKMK-së, për planifikimin, projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e shumë Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe shtimi i numrit të punëtorëve, si dhe bartja e të gjitha projekteve nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në AMKMK.

2. Korniza Ligjore

Baza ekzistuese ligjore që e rregullon Agjencinë është Ligji Nr.04/L-146 për AMKMK-në (GZRK) Nr.9/ datë 26.04.2013, që deri me tani nuk ka pasur ndonjë ndryshim plotësim dhe as vështirësi në zbatim të Ligjit.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës funksionon në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Agjencia ka Rregulloren e Brendshme Nr.02/2014 për Sistematizimin e vendeve të punës në AMKMK.

Në këtë Agjenci janë nxjerrë disa Akte nënligjore:

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2014 për Stemën e Agjencisë së AMKMK-së, Rregullorja Nr.03/2014 për punët në teren, punët shtesë dhe jashtë orarit, Rregullore Nr.04/2014 për caktimin e shpenzimeve të telefonave mobil dhe fiks të AMKMK-së, Rregullorja Nr.06/2017 për Krijimin e të Hyrave dhe është hartuar ProjektUdhëzimi Administrativ për përcaktimin e Kriteve për Komplekset dhe Memoriale të Kosovës në pajtim me Ligjin e AMKMK-së, mirëpo deri tani nuk është miratuar për shkak se mund të ketë pengesa në zbatim.

Deri në periudhën raportuese ju informojmë se në vitin 2016, AMKMK ka paraqitur kërkesë Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor të Kuvendit për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/39 për Shpalljen e Kompleksit Përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz-zonë me interes të veçantë nacional. Deri më tani për hartim të këtij Projektligji kanë ndihmuar Oda e Avokatëve të Kosovës për hartimin e Projektligjit në bashkëpunim me Komisionin funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe AMKMK e cila e ka hartuar Memorandumin shpjegues si pjesë përbërëse e Projektligjit. Oda e Avokatëve të Kosovës pas përfundimit të këtij Projektligji të njëjtin e ka dorëzuar në Komisionin Funkcional për Bujqësi, Pylltari Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe në Zyrën Ligjore. Komisioni ka proceduar më tutje Projektligjin për aprovim në Kuvendin e Kosovës.

3. Fushëveprimi i Agjencisë

Misioni: Krijimi i mundësisë për funksionimin e Agjencisë në pajtim me Ligjin në fuqi, duke u bazuar në Planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, dhe është kompetent për të gjitha Komplekset dhe Memorialet e Kosovës.

Vizioni: Kompletimi dhe funksionimi i Agjencisë, angazhimi në ngritjen dhe funksionalizimin e Komplekseve Memoriale, në mënyrë dhe në funksion të shtimit të numrit të vizitorëve.

Agjencia është përgjegjëse për menaxhimin e Komplekseve Memoriale të shpallura me vendim të Kuvendit si Zona me interes të veçantë kombëtarë dhe më karakter historik:

- Projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare;
- Përcaktimin e programeve kërkimore - shkencore, aktiviteteve dhe manifestimeve të ndryshme, që kanë të bëjnë me zonat dhe historinë e tyre;
- Bashkëpunimin me institucionet qeveritare dhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, Komunitatet përkatëse, Agjencitë turistike, për projektet që kanë të bëjnë me këto zona;
- Krijimin e Web-Faqes dhe mirëmbajtjen e linçeve të veçanta për Komplekse Memoriale, si dhe publikon revistën vjetore;
- Inicimin e procedurës për shpalljen e Zonave me interes të veçantë dhe përgatitë propozim vendimin për miratim në Kuvend;
- Hartimin e planeve hapësinore, urbane dhe rregulluese të Zonave me interes të veçantë, që kanë të bëjnë me Komplekset Memoriale;
- Hartimin e planeve për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale;

Propozon shpalljen e zonave me interes të veçantë kombëtar dhe me karakter historik.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës sipas organogramit ka dy Departamente: Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme dhe Departamentin për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim i cili ende nuk është funksionalizuar për shkak të mungesës së buxhetit.

4.Organizimi i Agjencisë

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës në strukturën organizative nuk ka Bord.

AMKMK në vitin 2016 ka pasur gjithsejt 11 punëtorë, nëntë prej tyre staf administrativ dhe dy ciceron në Kompleksin Memorial “Adem Jashari”-Prekaz.


Struktura e AMKMK-së është si në vijim:

- Drejtori i AMKMK-së dhe personeli mbështetës;
- Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme;
- Departamenti për Planifikim Projektim dhe Menaxhim të K.M.

Kapacitetet ekzistuese të AMKMK-së janë:

- Drejtori i AMKMK-së;
- Drejtori i DFSHP-së;
- Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa;
- Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit;
- Udhëheqës i Divizionit Ligjor;
- Zyrtare për Burime Njerëzore;
- Zyrtar i Logjistikës;
- Asistente Administrative;
- Zyrtar për Arkiv;
- Cicerona.

Organogrami i AMKMK-së



Numri i të Punësuarve në AMKMK në vitin 2016

AMKMK në vitin 2016 kishte të punësuar njëmbëdhjetë (11) nëpunës në këto kategori funksionale:

Nr.	Kategoritë funksionale	Numri i të punësuarve
1.	Niveli i lartë drejtues	1
2.	Niveli drejtues	4
3.	Niveli profesional	4
4.	Niveli tekniko administrativ	2

Nevojat për punëtor të rinj në AMKMK për vitin 2017

Në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2017 është plotësuar vetëm një pozitë e lirë e nivelit tekniko – administrativ, tani aktualisht janë të punësuar dymbëdhjetë (12) nëpunës, duke përfshirë Drejtorin e AMKMK-së që është i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nevojat për punëtor të rinj dhe avancimet në AMKMK parashihen:

Zyra e Drejtorit

Divizioni i Prokurimit:

- Zyrtar i Lartë i Prokurimit një (1) – avancim në pozitën Zyrtar i Lartë i Prokurim.

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme:

- Zyrtar i GIS – TI një (1)

Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim të Komplekseve

- Drejtor i Departamentit për Planifikim, Projektim dhe Menaxhim të K.M. - një (1);
- Udhëheqës të Divizionit për Planifikim, Projektim të K.M. – një (1);
- Udhëheqës të Divizionit për Menaxhim të K.M. – një (1);
- Ciceron – pesë (5).
- Roje - gjashtë (6).

Tabela e Trajnimeve të vitit 2016

Fusha e trajnimit	Numri i nëpunësve civil që janë trajnuar	Titulli i programit/kursit të trajnimit dhe kohëzgjatja e tij (nëse dihet)	Ofruesi i trajnimit	Muaji në të cilin është mbajtur trajnimi
Administratë dhe Legjislacion	1	Organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike	IKAP	Prill
Trajnime nga fusha e Burimeve Njerëzore	1	Kodi etik, të drejtat dhe përgjegjësitë në shërbimin civil	IKAP	Maj
		Menaxhimi Strategjik	IKAP	Maj
	1	Ankimimi dhe çështjet e disiplinës	IKAP	Qershor
	1	SIMBNJ	MAP	Korrik
	1	Menaxhimi i dokumenteve arkivore	IKAP	Prill
Prokurimi Publik	2	Prokurimi Publik	KRPP - MAP	Prill - Korrik
Buxhet dhe Financa	1	Moduli i planifikimit dhe monitorimit - programi I investimeve publike	MF	Maj

PLANI VJETOR I TRAJNIMIT I NËPUNËSVE CIVIL
për periudhën Janar 2017 – Dhjetor 2017

Nevojat për trajnim	Numri i nëpunësëve civil që duhen trajnuar	Titulli i programit/kursit të trajnimit dhe kohëzgjatja e tij (nëse dihet)		Ofruesi i trajnimit (nëse dihet)	Afati i parapëlqyer
Menaxhim i përgjithshëm	2	Lidershipi dhe menaxhimi	3 ditë	IKAP	Shkurt
	2	Hartimi, zbatimi, koordinimi dhe monitorimi i politikave	3	IKAP	Mars
	2	Planifikimi dhe vendimmarrja	3	IKAP	Maj
	2	Bazat e menaxhimit	3	IKAP	Qershor
	2	Menaxhimi Strategjik	3	IKAP	Korrik
	2	Sjellje organizative	3	IKAP	Gusht
	2	Menaxhimi i inovacioneve	3	IKAP	Shtator
Trajnime nga fusha Burimeve Njerëzore	1	Planifikimi, Rekrutimi dhe përzgjedhja	3	IKAP	Mars
	1	Vendosja e objektivave dhe vlerësimi të rezultateve në punë	3	IKAP	Mars
	1	Transferimi dhe promovimi në shërbimin civil	3	IKAP	Maj
	1	Ankimimi dhe çështjet e disiplinës	3	IKAP	Qershor
	1	Vlerësimi i nevojave për trajnim dhe ndërtimi i planeve të trajnimit	3	IKAP	Shtator

Administratë dhe Legjislacion	1	Vlerësimin e ndikimit rregullativ dhe hartimi i koncept dokumenteve	3	IKAP	Mars
	1	Procedura administrative	3	IKAP	Mars
	1	Organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike	3	IKAP	Prill
	1	Komunikimi dhe hartimi i shkresave në administratë publike	3	IKAP	Maj
Prokurimi Publik	2	Prokurimi i mallrave	3	IKAP	Mars
	2	Prokurimi i Shërbimeve	3	IKAP	Mars
	2	Standardet Ndërkombëtare dhe Legjislacioni i Prokurimit Publik	3	IKAP	Maj
	2	Prokurimi elektronik – (pranimi i ankesave në mënyrë elektronike)	3	IKAP	Qershor
Buxhet dhe Financa	1	Hartimi i Pasqyrave Nëntë Mujore (PNM)	3	IKAP	Mars
	1	Hartimi i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF)	3	IKAP	Mars
	1	Kontrolli dhe i Menaxhimi Brendshëm Financiar	3	IKAP	Prill
	1	Menaxhimi i financave publike	3	IKAP	Maj

	1	Trajnim planifikimin buxhetit,	për e	IKAP	Qershor
	1	Auditim të brendshëm		IKAP	Qershor
	1	Trajnim për Menaxhim të avancuar (Menaxhim i Projekteve dhe proceseve,		IKAP	Shtator

Asetet që ka në disponim AMKMK

Id e Artikullit të Pasurisë	Përshkrim i Artikullit të Pasurisë	Kodi i Klasës së Pasurisë	Përshkrim i Klasës së Pasurisë	Vlera origjinale	Ndryshim i vlerës	Amortizim	Vlera në libër
201400000 0007377	NDËRTIMI I GYPIT PËR FURNIZIM	31400	UJESJELLES	795,114.95	0.00	31,804.59	763,310.36
201400000 0007393	KRIJIMI I WEB-FAQES SË AMKMK-	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	6,850.00	0.00	856.25	5,993.75
201400000 0007610	DEFINIMI I KUFIRIT TE Z.V K.M	31900	KAPITAL TJETER	39,499.74	0.00	4,937.46	34,562.28
201400000 0007616	MIRËMBAJTJA E K.M-A.JASHARI-	32500	INVESTIMET NE VIJIM	28,480.14	0.00	0.00	28,480.14
201400000 0007623	MBIKQYRJA E PROJEKTIT NDERTIM	31400	UJESJELLES	9,780.28	0.00	391.21	9,389.07
201400000 0008145	HARTIMI I PLANIT TË MENAXH. K	31900	KAPITAL TJETER	44,900.00	0.00	4,490.00	40,410.00
8743	NDERTIMI I RRUGËS	31200	NDERTIMI I RRUGEVE	9,870.56	0.00	41.13	9,829.43
8903	HARTIMI I PROJEKTIT	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,790.00	0.00	81.58	9,708.42
8906	MATJET GJEOMEKANIKE	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,893.00	0.00	164.88	9,728.12
9203	PLOTESIM I PROJEKTIT	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,569.60	0.00	239.24	9,330.36
9208	KANALIZIMIT ATMOSFERIK	31250	KANALIZIMI	9,962.00	0.00	0.00	9,962.00
9211	HARTIMI I TERMAVE TE REFERENCE	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,490.00	0.00	316.33	9,173.67
9215	ELABORATIT I SHPRONËSIMIT	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,789.00	0.00	571.02	9,217.98
10141	MBIKQYRJA E PUNIMEVE - PENUHË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,800.00	0.00	81.67	9,718.33
10146	MBIKQYRJA E PUNIMEVE - MARINË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,689.00	0.00	0.00	9,689.00

10147	MBIKQYRJA PUNIMEVE KOSHARE	E -	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,950.00	0.00	0.00	9,950.00
10262	NDERT.I K.M"BETEJA KOSHARES"	E	32500	INVESTIMET NE VIJIM	569,838.60	0.00	0.00	569,838.60
10290	PUNËT SHITESË- MARINË		32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	31,329.58	0.00	0.00	31,329.58
10294	MIRËMBAJTJA E K.M"ADEM JASHARI	E	32500	INVESTIMET NE VIJIM	132,907.00	0.00	0.00	132,907.00
10309	SANIMI DËMEVE- PENUHË	I	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	30,967.74	0.00	0.00	30,967.74
10669	HART.PROJEKTI T TË KONZERVIMIT		31900	KAPITAL TJETER	491,964.00	0.00	24,598.20	467,365.80
10672	MIRËMBAJTJA E WEB-FAQES K.M	E	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	3,349.92	0.00	195.41	3,154.51
13421	VETURË KIA SPORTAGE	KIA	31706	VETURA ZYRTARE	19,990.00	0.00	0.00	19,990.00
13424	VETURË KIA SPORTAGE	KIA	31706	VETURA ZYRTARE	19,990.00	0.00	0.00	19,990.00
15584	EKZEKUTIMI I PUNIMEVE K.M MARINË	I	31900	KAPITAL TJETER	313,032.15	0.00	0.00	313,032.15
15586	MIRËMBAJTJA E WEB-FAQEVE	E	32200	PASURI FIKSE TË PAPREKSHME	3,600.00	0.00	0.00	3,600.00
15590	PUNËT SHITESË- KOSHARE		31900	KAPITAL TJETER	131,222.23	0.00	0.00	131,222.23
15592	PUNËT SHITESË- PENUHË		31900	KAPITAL TJETER	29,310.38	0.00	0.00	29,310.38
15599	EKZEKUTIMI I PUNËVE- PENUHË	I	31900	KAPITAL TJETER	301,144.06	0.00	0.00	301,144.06
20312	RINDËRTIMI I K.M KAÇANOLL	I	31900	KAPITAL TJETER	93,300.00	0.00	0.00	93,300.00
20316	PUNËT SHITESË- KAÇANOLL		31900	KAPITAL TJETER	6,687.80	0.00	0.00	6,687.80
20522	BAZAMENTI- HYRË EMINI- FERIZAJ		31900	KAPITAL TJETER	8,061.00	0.00	0.00	8,061.00
20533	BAZAMENTI- WILLIAM WALKER- RAÇAK		31900	KAPITAL TJETER	69,611.70	0.00	0.00	69,611.70

20541	PUNËT SHITESË- BAZAMENTI RAÇAK	31900	KAPITAL TJETER	6,780.50	0.00	0.00	6,780.50
20582	SHTATORJA "HYRË EMINI"- FERIZAJ	31900	KAPITAL TJETER	49,500.00	0.00	0.00	49,500.00
20591	SHTATORJA "WILLIAM WALKER"- RAÇAK	31900	KAPITAL TJETER	98,892.96	0.00	0.00	98,892.96
20609	K.M "DËSHMORËT E KOMBIT"- VRELLË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	38,000.00	0.00	0.00	38,000.00
20637	DRENAZHIMI I VARREZAVE- KOSHARE	31250	KANALIZIMI	33,499.30	0.00	0.00	33,499.30
20654	PUNIMET FAZA IV K.M-MARINË- 2016	32500	INVESTIMET NË VIJIM	12,216.70	0.00	0.00	12,216.70
20703	MIRËMBAJTJA K.M "A.JASHARI"- 2016	32500	INVESTIMET NË VIJIM	115,761.83	0.00	0.00	115,761.83
20708	K.M-PENUHË- 2016	32500	INVESTIMET NË VIJIM	320,475.96	0.00	0.00	320,475.96
20714	K.M "BETEJA E KOSHARES"- 2016	32500	INVESTIMET NË VIJIM	688,146.19	0.00	0.00	688,146.19
20719	MIRËMBAJTJA K.M "ZAHIR PAJAZITI"-2016	32500	INVESTIMET NË VIJIM	28,633.20	0.00	0.00	28,633.20
Total				4,670,641.07	0.00	68,768.97	4,601,872.10

AMKMK-ja, sipas ligjit obligohet të menaxhojë me të gjitha asetet e veta në Komplekset Memoriale të Kosovës, përkatësisht investimet kapitale të bëra në këto Memoriale.

Hapësira për punë:

AMKMK-ja është e vendosur në ndërtesën e objektit të ish Gjykatës Themelore Prishtinë, dhe ka hapësirë të mjaftueshme për këtë numër të stafit të punëtorëve.

5. Aktivitetet për Periudhën Raportuese

Aktivitetet të cilat janë ndërmarrë gjatë vitit 2016

- Bartja e projekteve të Komplekseve dhe Memorialëve nga MMPH sipas Ligjit për Agjencinë në AMKMK ku shumica janë bartur pjesërisht, ndërsa pjesa tjetër pritet të barten deri në fund të vitit;
- Ekzekutimi i buxhetit për vitin 2016;
- Planifikimi buxhetor për vitin 2017;
- Ekzekutimi i planit të prokurimit për vitin 2016;
- Planifikimi i prokurimit për vitin 2017;
- Planifikimi i personelit për vitin 2017;
- Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e K M “Adem Jashari”;
- Mirëmbajtja e web-faqes së K M, Adem Jashari – Prekaz Skenderaj dhe web-faqes së AMKMK-së;
- Inicimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/39 për Shpalljen e Kompleksit Përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz-Zonë me Interes të veçantë nacional;
- Funksionalizimi i mini muzeut në objektin e recepsionit në K.M “Adem Jashari”- Prekaz;
- Ekzekutimi i punimeve të fazës së dytë në K.M “Beteja e Koshares”- Koshare;
- Ekzekutimi i punimeve të fazës së tretë dhe sanimi i dëmeve në K.M “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së”- Marinë, Skenderaj;
- Hartimi i Akteve nënligjore tjera;
- Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019;
- Planifikimi i Buxhetit të AMKMK-së sipas Qarkoreve Buxhetore;
- Hartimi i Raportit dhe Pasqyra Financiare për periudhën vjetore dhe nëntë mujore të vitit 2016;
- Raportimi mujor i obligimeve të papaguara gjatë vitit 2016;
- Barazimi i shpenzimeve të AMKMK-së me Departamentin e Thesarit çdo tre muaj;
- Hartimi i planit vjetor të punës së AMKMK-së për vitin 2016;
- Furnizimi dhe shtypja e broshurave dhe ceradave për ngritjen e mini Muzeut në K.M. Adem Jashari – Prekaz;
- Furnizim me material shpenzues-fletëpalosje etj;
- Furnizimi dhe montimi i kornizave për panelet që do të vendosen në mini Muzeun në K.M. Adem Jashari – Prekaz;
- Furnizim me vetura për nevojat e AMKMK-së;
- Furnizim me pajisje për zyre;
- Furnizim me perde, xhama dhe dorëza për dritare – AMKMK;
- Ofrimi i shërbimeve të nevojshme në Kompleksin Memorial “Kulla e Zahir Pajazitit” në Orllan Podujevë;
- Furnizimi me ngjyrë dhe material tjetër për zyrat e reja të AMKMK-së;

- Ndërtimi i Varrezave dhe Rivarrimi i Dëshmorëve të Zonës së Llapit K.M. “Dëshmorët e UÇK-së” Penuhë – Podujevë;
- Realizimi në skulpturë të shtatores kushtuar Ambasadorit ” William Walker” në Kompleksin Memorial “Masakra e Raçakut” Raçak – Shtime;
- Ndërtimi i Bazamentit të Shtatores së Ambasadorit William Walker – Raçak;
- Furnizim me inventar për zyrat e reja të AMKMK-së;
- Matjet gjeodezike në K.M. “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së” Marinë - Skenderaj dhe në K.M. “Dëshmorët e Kombit” Vrellë – Istog;
- Furnizimi me material dhe punimi i shenjzimit horizontal i rrugës dhe hapësirës së parkingjeve në K.M. “ Varrezat e Dëshmoreve të UÇK-së, Marinë” – Skenderaj;
- Mirëmbajtja e Web faqes së AMKMK-së dhe K.M. “Adem Jashari” Prekaz;
- Rindërtimi i Memorialit të Dëshmorëve të UÇK-së, Kaçanoll – Podujevë;
- Realizimi në skulpturë - “Shtatorja e Dëshmores Hyrë Emini” – Ferizaj;
- Ndërtimi i bazamentit - “Shtatorja e Dëshmores Hyrë Emini” – Ferizaj;
- Furnizim me Orman për deponë (Arkivin) e AMKMK-së;
- Ndërtimi i Kompleksit Memorial “Dëshmorët e Kombit” në Vrellë-Istog;
- Vendosija e Tabelave Orientuese për K.M. “Adem Jashari” – Prekaz;
- Furnizim me Goma te Dimrit për dy Vetura KIA-AMKMK;
- Furnizim me printer dhe material tjetër shpenzues për nevojat e AMKMK-së;
- Ekzekutimi i Drenazhimit të Varrezave të Dëshmorëve në K.M. “Beteja e Koshare” – Koshare;
- Furnizim me flamuj për Komplekse Memoriale.

Planet që parashikohen për vitin - 2017:

- Bartja e të gjitha projekteve nga MMPH në AMKMK që kanë të bëjnë me komplekset dhe memorialet;
- Inicimi i procedurave të Prokurimit për fillimin e ekzekutimit të konservimit të shtëpive të rezistencës në Kompleksin Memorial Adem Jashari Prekaz Skenderaj, rishpallja e konkursit për hartimin e projektit të përgjithshëm Urbanistik. Blerja dhe mbjellja e 59 fidanëve simbol i të rënëve në Betejën e 5, 6, 7 Mars 1998;
- Mirëmbajtja e K.M Adem Jashari – Prekaz, Skenderaj;
- Funksionimi normal i Mini-Muzeut në K.M “Adem Jashari”-Prekaz;
- Inicimi i procedurave për ekzekutimin e punimeve në Kompleksin Memorial Beteja e Koshares-Koshare, Gjakovë - faza e tretë;
- Ekzekutimi i punimeve të fazës së katërt në K.M “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së”- Marinë, Skenderaj;
- Vazhdimi i punimeve në ndërtimin e varrezave të dëshmorëve dhe rivarrimi i tyre në Kompleksin Memorial Dëshmorët e UÇK-së- Penuhë -Podujevë;
- Mirëmbajtja dhe ruajtja e K.M “Dëshmorët e UÇK-së- Penuhë -Podujevë”, pas përfundimit të punimeve të fazës finale;
- Mirëmbajtja dhe ruajtja e K.M “Kulla e Zahir Pajazitit”- Orllan, Podujevë;
- Ekzekutimi i punimeve në K.M “Masakra e Raçakut” – Raçak, Shtime;
- Mirëmbajtja dhe ruajtja e K.M “Masakra e Raçakut” – Raçak, Shtime;
- Ngritja e shtatoreve të heronjve Hakifit, Zahirit, Ilirit dhe Edmondit, në sheshin në Podujevë;
- Vazhdimi i Ekzekutimit të punimeve të K.M “Dëshmorët e Kombit” – Vrellë, Istog - faza e parë;
- Përzgjedhja e kompanisë profesionale mbikëqyrëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të projekteve të AMKMK-së;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit, trajnime dhe seminare;
- Mirëmbajtja e web-faqes së AMKMK-së dhe K.M Adem Jashari, Prekaz – Skenderaj;
- Bashkëpunimi me Institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
- Plotësimi i stafit me punëtor të ri;
- Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit të AMKMK-së;
- Lidhur me këto AMKMK ka zhvilluar aktivitet duke bërë kërkesat për rritjen e stafit dhe për projekte kapitale në Ministri të Financave.

Agjencia do të bëjë përpjekje për realizimin e këtyre aktiviteteve të rëndësishme.

6. Pjesa e fundit e raportit- rekomandimet / sfidat e Institucionit (Rritja e stafit, ndryshimi i Ligjit)

Stafi i AMKMK-së është trajnuar dhe kualifikuar për punët dhe detyrat shtesë të domosdoshme për funksionimin më të mirë të Agjencisë.

Agjencia prej themelimit ka pasur shumë sfida, si mungesa e buxhetit, mungesa e stafit, ngecja dhe mos bartja e të gjitha projekteve nga MMPH në AMKMK.

Prandaj, për t'i realizuar tërë objektivat duhet të bëhet ndarja e buxhetit të mjaftueshëm, sipas parashikimeve tona, si:

- Rritja e numrit të punëtorëve të AMKMK-së: punësimi i stafit në administratë, punësimit të ciceronëve, rojeve dhe mirëmbajtja e komplekseve memoriale;

- Rritja e buxhetit për projekte kapitale - Komplekseve Memoriale;

- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime si dhe

- Është e domosdoshme rritja e buxhetit për shpenzime komunale me qëllim të kryerjes së të gjitha detyrimeve, sepse ndarja e mjeteve buxhetore në këtë linjë i mbulon shpenzimet për të gjitha Komplekset dhe Memorialët vetëm 25%. Andaj kërkojmë që për kryerjen e këtyre obligimeve pa probleme të ndahen mjete të mjaftueshme financiare.

Rekomandojmë se për funksionalizimin e agjencisë duhet të merren më seriozisht Komisioni funksional BPMPH, Komisioni për Buxhet dhe Financa në kuadër të Kuvendit të Kosovës dhe në anën tjetër edhe Qeveria dhe Ministria e Financave.

Një prej qëllimeve që ka mbetur i paarritur është:

- Rritja e stafit, e bashkë me këtë edhe rritja në kategorinë mallra dhe shërbime.

Mungesa e mjeteve financiare dhe duke pasur parasysh numrin e madh të Komplekseve dhe Memorialeve në Kosovë që parashihen të ndërtohen, menaxhohen dhe disa të ndërtuara më herët që janë dëmtuar e që duhet patjetër të sanohen dhe të mirëmbahen, është e nevojshme që të kemi buxhet dhe staf të mjaftueshëm.

Planifikimi për vitin e ardhshëm do të parashihet në arritjen e këtyre objektivave, me qëllim të ngritjes, menaxhimit të Komplekseve dhe Memorialeve që janë përgjegjësi e AMKMK-së, njëkohësisht bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punëve me institucionet tjera përkatëse.

7. Raporti Financiar

Buxheti fillestar për AMKMK-në për vitin 2016 ishte: 2,134,797.00 €; Buxheti me Rishikim Buxhetor 2016: 2,438,256.00€; Buxheti final: 1,940,843.68€.

Kategoritë	Buxheti fillestar	Buxheti me rishikim buxhetor	Buxheti përfundimtar	Shpenzimet 2016	%
Paga e mëditje	81,012.00	81,012.00	81,339.42	81,339.42	100
Mallra e shërbime	44,535.00	44,535.00	34,649.92	34,649.92	100
Shpenzimet komunale	9,250.00	9,250.00	29,250.00	29,169.36	99.72
Investimet kapitale	2,000,000.00	2,303,460.00	1,795,604.34	1,795,552.45	99.99
Totali	2,134,797.00	2,438,256.00	1,940,843.68	1,940,711.15	99.99

Me buxhetin e vitit 2016 kanë qenë të lejuar njëmbëdhjetë (11) pozita për AMKMK-në dhe janë plotësuar të gjitha pozitat.

AMKMK-së nuk i kanë mjaftuar mjetet për të mbuluar pagat për muajin Dhjetor dhe kemi pasur rritje të buxhetit në paga prej 327.42€ nga Ministrinë e Financave.

Për shkak të borxhit të madh të shpenzimeve të energjisë elektrike dhe grumbullimit të mbeturinave në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" Prekaz, në Kompleksin Memorial Dëshmorët e UÇK-së në Penuhë dhe Zahir Pajaziti në Orllan, AMKMK ka bërë kërkesë në Ministrinë e Financave për transferim të mjeteve nga kapitalet në komunali e cila kërkesë është aprovuar.

Ndarja finale e buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale është ndryshuar pas kërkesës së AMKMK-së në MF për transferim të mjeteve nga kapitalet në komunali me vlerë prej 20,000.00€, për shkak të borxhit të madh në shpenzimet komunale dhe kërkesa e AMKMK-së është aprovuar nga MF.

Me Vendim të Qeverisë Nr.08/113 AMKMK ka pasur harmonizim të brendshëm (transfere dhe rialokime) brenda organizatës buxhetore, për vitin 2016: 490,000.00€ nga kodi i projektit 13851 dhe prej tyre rialokimi i mjeteve në projektin me kod 14362, 315,000.00€; 175,000.00€ në projektin me kod 14363.

Me Vendim të Qeverisë kemi pasur shkurtim (kursime) në investime kapitale për mjetet e lira.

Këtij Raporti Vjetor të Punës do t'ia bashkangjesim edhe Raportin Vjetor Financiar 2016 të AMKMK-së.

8. Raportimi rreth adresimit të Rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Nr	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose propozuar	Afati i zbatimit	Vleresimi i rrezikut
1	Klasifikimin korrekt të shpenzimeve në buxhet në mënyrë që shpenzimet të mund të realizohen dhe të regjistrohen në kategoritë buxhetore adekuate. Kjo mundëson paraqitje me të qartë lidhur me natyrën e shpenzimeve të realizuara dhe të prezantuara në PVF.	Pajtueshmërine me Rregullës Financare nr. 03/2013; Kërkesat e LMFP-së nr, 03/L-048; Si dhe kërkesat tjera për raportim të nxjerra nga MF	Gjatë vitit 2016	Pasqyrimi i drejtë i PVF
2	Plani i veprimit i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e rekomandimeve që nuk janë implementuar dhe atyre të pa adresuara	Zbatimi i planit të veprimit	Gjatë vitit 2016	Mos implementimi i plotë i rekomandimeve nga viti paraprak.
3	Hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të institucionit, përfshirë planin për menaxhimin e rreziqeve potenciale që do të kërcënonin arritjen e objektivave të synuara.	AMKMK ka themeluar grupin punues për hartimin e strategjisë gjithëpërfshirëse por kemi mungesë të mjeteve.	Gjatë vitit 2016	Mungesa e Strategjisë shkakton paqartësi rreth misionit, vizionit dhe synimeve të organizatës.

4	Hartimi i listës së rreziqeve potenciale së bashku me masat e nevojshme për menaxhimin e tyre si dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.	AMKMK ka punuar në listën e rreziqeve.	Gjatë vitit 2016	Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë nuk adresohen në kohën e duhur.
5	Monitorimi i performancës buxhetore dhe realizimi i projekteve në baza mujore dhe identifikimi, adresimi me kohë barrierat në dinamikën e realizimit të buxhetit.	AMKMK gjatë këtij viti është munduar që realizimin e buxhetit të projekteve ta bëjë sipas planifikimit.	Gjatë vitit 2016	Mbetja e shumë pagesave në fund të vitit mund të shkaktojë ngarkesë dhe mund të ketë mos aplikim efektiv të kontrolleve.
6	Sigurimi që të gjitha projektet e planifikuara të jenë të hartuara mirë dhe të detajuara në mënyrë që të shmang kostot shtesë.	Projektim më i mirë i projekteve.	Gjatë vitit 2016	Planifikimet jo të mira të projekteve ndikojnë edhe në planifikime jo adekuate buxhetore.
7	Sigurimi që në rastet kur shfaqet nevoja për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm, angazhimi i tyre të bëhet përmes procedurave transparente për angazhimin siç parashihet me rregullat në fuqi.	AMKMK çështjen e angazhimit të ekspertëve e ka të rregulluar me Udhëzim Administrativ.	Gjatë vitit 2016	Kontraktimi i shërbimeve në mungesë të procedurave të kërkuara, mund të ndikojë që të angazhohen personat joadekuat si dhe zvogëlon transparencën e proceseve brenda institucionit.

8	Pozitat të plotësohen me staf të rregullt dhe kontrata të punës.	Për shkak të mungesës së mjeteve AMKMK është detyruar të angazhojë punonjës me kontrata mbi shërbimet e veçanta. Në momentin e sigurimit të mjeteve do të plotësohet stafi i rregullt.	Gjatë vitit 2016	Angazhimi i punonjësve me kontrata mbi shërbimet e veçanta minimizon konkurrencën dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat në pozitat e caktuara.
---	--	--	------------------	---

9. Shtojcat

Në AMKMK janë nxjerrë Vendime të rëndësishme si:

- Vendime për Formimin e Komisioneve të ndryshme për hapjen dhe vlerësimin e Ofertave -AMKMK;
- Vendim për caktimin e menaxherëve për mbikëqyrjen e projekteve kapitale;
- Vendime për caktimin e ekspertëve vendor dhe të jashtëm për përcjelljen e punës në hartimin e projektit ideor dhe kryesor në konservimin e shtëpive të rezistencës në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" Prekaz- Skenderaj;
- Vendim për Komisione për rekrutimin e Shërbyesve Civil;
- Vendim për Komisionin Konteste dhe Ankesa dhe Komisionin për Shkelje Disiplinore;
- Vendim për pranimin teknik të projekteve kapitale të cilat i ka investuar AMKMK;
- AMKMK nuk ka Bord dhe nuk është Autoritet Rregullativ nuk lëshon dhe revokon Licenca.

Për funksionimin normal të AMKMK-së, është me rëndësi të ketë rritje të Buxhetit të Agjencisë nga Ministria e Financave. Mungesa e mbështetjes së nevojshme financiare dhe mos trajtimi me kompetencë i kësaj çështje nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës është dhe mbetet pengesa kryesore në arritjen e objektivave të parashikuara të Agjencisë.

AMKMK do të përmbushë në mënyrë më efikase detyrat dhe përgjegjësitë të cilat i rregullon Ligji Nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Me respekt.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija sa Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova
Agency on Menagement of Memorial of the Complexes of Kosovo

AMKMK

DFSHP

Plani i Punës 2017

Kuvendi i Kosovës - Prishtinë

Detyrat dhe Përgjegjësitë e AMKMK-së

Agjencia është përgjegjëse për menaxhimin e Komplekseve Memoriale të shpallura me vendim të Kuvendit si Zona me interes të veçantë kombëtarë dhe më karakter historik;

- Projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare;
- përcakton programet kërkimore - shkencore, aktivitetet dhe manifestimet e ndryshme, që kanë të bëjnë me zonat dhe historinë e tyre;
- bashkëpunimin me institucionet qeveritare dhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, Komunitetet përkatëse, Agjencitë turistike, për projektet që kanë të bëjnë me këto zona;
- krijimin e VebFaqes dhe mirëmbajtjen e linçeve të veçanta për Komplekse Memoriale, si dhe publikon revistën vjetore;
- iniciimin e procedurës për shpalljen e Zonave me interes të veçantë dhe përgatitë propozim vendimin për miratim në Kuvend;
- hartimin e planeve hapësinore, urbane dhe rregulluese të Zonave me interes të veçantë, që kanë të bëjnë me Komplekset Memoriale;
- hartimin e planeve për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale;
- propozon shpalljen e Zonave më interes të veçantë kombëtarë dhe me karakter historik.

Aktivitetet e AMKMK - së Për vitin 2017

AMKMK është përgjegjëse për Komplekset Memoriale në kuadër të zonave të veçanta për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

AMKMK gjatë vitit 2017 parasheh të kryej këto punë - aktivitete:

Në kuadër të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme janë këto aktivitete: Financa, administratë – personel, logjistikë, legjislacion, TI - GIS Aktivitetet e Prokurimit.

Në kuadër të Departamentit të Planifikimit Projektimit dhe Menaxhimit të Komplekseve Memoriale, janë këto aktivitete: planifikimi, ekzekutimi i punimeve, menaxhimi dhe ruajtja e tyre.

I- Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme gjatë vitit 2017 parasheh të kryej këto aktivitete:

1. Administrata, personeli dhe informimi:

- Hartimi i Planit Individual të Personelit të AMKMK-së për vitin 2017;
- Planifikim dhe Identifikim të vendeve të lira të punës dhe parashikimi i kërkesës për staf sipas prioriteteve;
- Raport për vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësit e AMKMK-së për vitin 2016;
- Hartimi i planit të trajnimeve 2017, sipas nevojave të stafit;
- Hartimi i Raportit Vjetor 2016 për njësinë e burimeve njerëzore;
- Menaxhimi i Sistemit Informativ për Burimet Njerëzore: Moduli për proceduarat e rekrutim, Moduli për aplikim, Moduli për administrim të nëpunësve civil dhe moduleve të tjera;
- Sigurimi i listës së pagave të stafit të institucionit do të përgatitet në pajtim me procedurat ligjore;
- Menaxhimi i të gjitha llojeve të pushimeve të stafit të AMKMK-së;
- Menaxhimi i dosjeve të personelit me të dhëna dhe dokumente relevante;
- Mbështetë punën e Komisionit për ankesa dhe parashitë dhe Komisionit disiplinor;
- Siguron zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore;
- Punët për komunikim dhe informimi në web - faqen e AMKMK-së.

2. Buxheti dhe Financat:

- Hartimi i ndryshimeve në buxhetin e AMKMK-së të vitit 2017 sipas nenit 7. të Ligjit të Buxhetit.
- Hartimi i cash flow-it 2017 për kategorinë paga & mëditje, mallra e shërbime dhe investime kapitale.
- Raportimi i obligimeve të papaguara gjatë vitit 2016 dhe që barten si obligime në vitin 2017.
- Barazimi i shpenzimeve të AMKMK-së me Departamentin e Thesarit për vitin fiskal Janar –Dhjetor 2016.
- Kërkesat për procedim të pagesave të ndryshme dhe përfundimi i pagesave sipas afatit të paraparë.
- Hartimi i Raportit Vjetor Financiar 2016 për Departamentin e Thesarit - MF.
- Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2018-2020 të AMKMK-së.
- Raporti Vjetor Financiar 2016 për Kuvendin e Kosovës.
- Raporti dhe pasqyrat financiare 2017 tre mujore, gjashtë mujore dhe nëntëmujore të AMKMK-së.
- Raportimi mujor i obligimeve të papaguara gjatë vitit 2017.
- Barazimi i shpenzimeve të AMKMK-së dhe Departamentit të Thesarit për tre muaj, gjashtë muaj dhe nëntë muaj.
- Hartimi i kërkesave Buxhetore sipas Qarkoreve Buxhetore 01/2018; 02/2018 dhe 03/2018 duke përfshirë planifikimin e buxhetit operativ në sistemin BDMS dhe planifikimin e projekteve kapitale në sistemin e PIP-it.
- Dorëzimi i kërkesës buxhetore të AMKMK-së për rishikimin buxhetor 2017 në Ministrinë e Financave.
- Punë të tjera të cilat kërkohen sipas Ligjit të Buxhetit 2017 dhe Rregulloreve Financiare në fuqi për vitin fiskal 2017.
- Menaxhimi i shpenzimit dhe verifikimi i parasë së imët (petty cashit) e avanseve të AMKMK-së.

3. Legjislacioni:

Në këtë Agjenci janë nxjerrë disa Akte nënligjore:

Akt i Brendshëm i Agjencisë është Rregullorja e Brendshme Nr.02/2014 për Sistematizimin e vendeve të punës në AMKMK.
 Udhëzimi Administrativ Nr.01/2014 për Stemen e Agjencisë së AMKMK-së,
 Rregullorja Nr.03/2014 për punët në teren, punët shtesë dhe jashtë orarit, Rregullore Nr.04/2014 për caktimin e shpenzimeve të telefonave mobil dhe fiks të AMKMK-së,
 Rregullorja Nr.06/2017 për Krijimin e të Hyrave dhe është hartuar ProjektUdhëzimi Administrativ për përcaktimin e Kritereve për Komplekset dhe Memoriale të Kosovës në pajtim me Ligjin e AMKMK-së, mirëpo deri tani nuk është miratuar për shkak se mund të ketë pengesa në zbatim.

Deri në periudhën raportuese ju informojmë se në vitin 2016 AMKMK ka paraqitur kërkesë Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor të Kuvendit për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/39 për Shpalljen e Kompleksit Përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz-zonë me interes të veçantë nacional. Deri më tani për hartim të këtij Projektligji kanë ndihmuar janë angazhuar edhe Oda e Avokatëve të Kosovës për hartimin e Projektligjit në bashkëpunim me Komisionin funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe AMKMK e cila e ka hartuar Memorandumin shpjegues si pjesë përbërëse e Projektligjit.
 Oda e Avokatëve të Kosovës dorëzon Projektligjin në Komisionin FunkSIONAL BPMPH dhe në Zyrën Ligjore. Komisioni do të procedoj në procedurat e mëtutjeshme të Projektligjit për aprovim në Kuvendin e Kosovës.

4. Prokurimi:

- Në konsultim me të gjitha departamentet apo njësitë e kërkesës përgatitë një plan vjetor të prokurimit dhe vendos kërkesat sipas prioritetit;
- Hartimi i planit paraprak apo preliminar të aktiviteteve të prokurimit që do të zhvillohen në vitin 2017;
- Hartimi i planit final të prokurimit në bazë të ndarjes buxhetore 15 ditë pas aprovimit të buxhetit për vitin 2017;
- Përpilimi i Raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2016 sipas kërkesës së KRPP-së. Raporti duhet të përfshijë të gjitha llojet e kontratave me vlerë të madhe, të mesme, të vogël dhe minimale;
- Menaxhimi me arkivimin dhe sistemimin e dokumenteve të prokurimit;
- Informimin publik dhe hartimin e raporteve të ndryshme;

- Zhvillimi i platformës elektronike të e- prokurimit;
- Ndihmë Profesionale stafit në AMKMK;
- Mirëmban dhe arkivon të dhëna për prokurime;
- Menaxhimi me zyrën e prokurimit, harmonizimi i punëve me Sektorin për Buxhet dhe Financa;
- Përgjegjësi për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të AK brenda kompetencave të tij dhe në pajtim me dispozitat e LPP.
- Procesi i prokurimit administrohet përmes 8 hapave në vijim:
 - Planifikimi i Prokurimit;
 - Parashikimi i Vlerës;
 - Klasifikimi i Kontratës;
 - Përcaktimi i Procedurës së Prokurimit;
 - Përgatitja e Dosjes së Tenderit, Shpallja;
 - Hapja dhe Vlerësimi i Tenderëve;
 - Dhënia dhe Nënshkrimi i Kontratës;
 - Menaxhimi i Kontratës.

Pranimi i kërkesave për prokurim.

Para fillimit të aktivitetit të prokurimit siguron që fondet janë në disponueshmëri dhe të autorizuar me shkrim.

Përcaktimi i Procedurës së Prokurimit

Siguron që nuk ka kufizime në specifikime, ose TeR, në mënyrë që të sigurohet konkurrenca maksimale;

Përgatit dokumente parakualifikuese, dosje të tenderit ose kërkesat për kuotim, kushtet e kontratës, dhënie e kontratës, raportet e vlerësimit të tenderëve etj, duke përdorur formularët standard të aprovuar;

Përgatitja e njoftimeve indikativë për vlerat e mëdha për furnizime, shërbime dhe punë.

Njoftimet në KRPP në të dy gjuhët për vlerat e vogla dhe të mesme ndërsa njoftimi në tre gjuhë për vlerat e mëdha.

Organizon dhe menaxhon takimet para-ofertuese, hapjet e tenderëve dhe procesin e vlerësimit.

Rekomandon përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Hapjes së Tenderëve/të Vlerësimit të Tenderëve.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, shqyrton propozimin për kontratë të rekomanduar nga komisioni vlerësues; Pranon/refuzon rekomandimin e propozuar. Përgatit dhe publikon dhënien e kontratave.

Përgatitja e draft kontratës, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

- Nënshkruan kontratat pas rikonfirmimit që informatat financiare nuk kanë ndryshuar substancialisht;
- Dhe në fund përcjellja e realizimit të kontratave;
- Sipas nevojës takime në KRPP, OSHP dhe takime tjera APP.

5. Logjistika:

- Ofrimi i ndihmës logjistike për takimet e personelit të Agjencisë;
- Menaxhimi i inventarit të AMKMK-së;
- Koordinimi i kërkesave dhe nevojave të Agjencisë për mallra dhe pajisje të zyrës për punë;
- Menaxhimi i transportit dhe automjeteve të Agjencisë, mirëmbajtje dhe servisim;
- Bashkëpunimi në përgatitjen dhe hartimin e broshurave dhe revistave të Agjencisë;
- Mbështetje teknike për pajisjet e stafit (PC) etj;
- Inventarizimi i zyrave të reja dhe menaxhimi i inventarit;
- Furnizimi i zyreve me inventar të ri dhe material shpenzues;
- Ndhimë logjistike Komplekseve Memoriale për furnizim me inventar dhe pajisje etj.

6. IT- GIS:

- Në mungesë të zyrtarit tonë, shërbimet e IT – së dhe GIS –it do të vazhdojmë t'i kryejmë nga IT ja e Ministrisë së Diasporës dhe në disa raste edhe IT e MAP – it pasi që neve nuk po na lejohet të punësojmë një zyrtar që do t'i kryej këto punë.

II- Departamenti i Planifikimit Projektimit dhe Menaxhimit të Komplekseve dhe Memorialeve.

A. Këtë vit pritet të funksionalizojmë edhe këtë Departament, duke filluar nga Drejtori dhe pastaj punësimin edhe te ndonjë arkitekti apo inxhinieri si dhe disa roje. Mirëpo edhe pse MF nuk na ka lejuar mjete për paga dhe mëditje për plotësimin e pozitave të lira, ne do të bëjmë përpjekje për të biseduar me MF dhe MAP duke ju sqaruar nevojën dhe rëndësinë e punësimit të punonjësve të lartë cekur.

Ky departament ka nën menaxhim Projektet Kapitale, për Komplekset Memoriale. Në kuadër të këtij Departamenti jemi duke ndërtuar planifikuar dhe menaxhuar këto Komplekse Memoriale:

1. Kompleksi Memorial "Adem Jashari" Prekaz:
 - Revidimi i Projektit të Konservimit;
 - Ekzekutimi i Konservimit të shtëpive të Rezistencës;
 - Hartimi i Planit të Përgjithshëm Urbanistik;
 - Mbjellja e fidanëve, simbol i 59 të rënëve në betejën e 5,6 dhe 7 Marsit;
 - Ndërtimi i Amfiteatrit;
 - Shpronësimin.
2. Mirëmbajtja e K. M. "Adem Jashari" Prekaz
3. Vazhdimi i Ndërtimit të fazës së dytë K. M. "Beteja e Koshares" Koshare.
 - Vazhdimi i punimeve të kësaj faze.
4. Ndërtimi i Fazës së tretë dhe evitimi i dëmeve në K. M. "Varrezat e Dëshmorëve të UÇK – së Marinë Skenderaj".
 - Vazhdimi i punimeve dhe përfundimi i kësaj faze pasi të jenë bartur varrezat e dëshmorëve.

5. Ndërtimi i Fazës së tretë në K. M. "Varrezat e Dëshmorëve të UÇK – së Penuhë, Podujevë;
 - Përfshihen ndërtimi i varrezave dhe rivarrimi i eshtrave të dëshmorëve të zonës së Llapit.
6. Ndërtimi i fazës përfundimtare të K. M. "Masakra e Raçakut" Raçak- Shtime
 - Do të kryhet ndërtimi i pjesëve të mbetura nga projekti i këtij Memoriali.
7. Mirëmbajtja e K. M. "Kulla e Zahir Pajazitit" Orllan Podujevë.
8. Kompleksi Memorial "Dëshmorët e Kombit" Vrellë Istog.
 - Ndërtimi i memorialit.
9. Kompleksi Memorial "ZIV Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë- Malet e Berishës.
 - Shpronësim
 - Ekzekutim të restaurimit dhe konservimit.
10. Memoriali Masakra e Likoshanit – Drenas- konservimi i shtëpive të familjes Ahmeti.
 - Shpronësim
 - Ekzekutim të restaurimit dhe konservimit.
11. Kompleksi Memorial "27 Prilli" Meje, Gjakovë.
 - Ekzekutimi i punimeve
12. Ndërtimi i shtatoreve të Zahirit, Edmondit, Hakifit dhe Ilir Konushevcit në qendër të Podujevës.
 - Ngritja e shtatoreve në shesh- përmes përzgjedhjes me konkurs projektimi.
13. Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit Adem Jashari, Malishevë.
 - Mirëmbajtja e sheshit.
14. Kompleksi i varrezave të dëshmorëve të brigadës 121 të UÇK-së, Ismet Jashari – Kumanova, Kleçkë –Divjakë, Lipjan.
 - Mirëmbajtja e varrezave dhe evitimi i dëmeve.
15. Restaurimi dhe konservimi i shtëpive muze në lagjen Jashari – Prekaz.
16. Rregullimi i varrezave në Polac.
17. Kompleksi memorial "Demë Ahmetit", Podujevë.
18. Ndërtimi i sheshit "Hasan Prishtina" Vushtrri.
19. Mirëmbajtja e kompleksit "Baza e Parë e UÇK-së", Podujevë.

B. Gjatë vitit 2018 do të punojmë në drejtim të gjetjes së mundësive të financimit edhe të projekteve tjera që veç janë të futura në PIP- sistem dhe që pritet të ngriten duke filluar nga Planifikimi, Ndërtimi dhe në fund Menaxhimi i tyre.

20. Memoriali "Ibrahim Rugova dhe Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së" Prishtinë.
21. Kompleksi Memorial "Shtabi dhe Varrezat e UÇK-së Gllogjan, Deçan;
22. Memoriali "Dëshmorët e UÇK-së Shqiponjë" (ish Jabllanica)" Gjakovë;
23. Memoriali " Metush Krasniqi"- Dajkoc - Kamenicë;
24. Memoriali "Obelisku Afrim Zhitia" Lluga- Podujevë;
25. Memoriali "Dëshmorët" e UÇK-së" Landovicë- Prizren;
26. Konservimi i "Fshati Memorial Strazhë" Kaçanik;
27. Projekti për Intervenime Emergjente në Komplekse Memoriale Varreza të Dëshmoreve dhe Martirëve etj.
28. Kompleksi i Varrezave "Masakra e Krushës së Madhe" – mirëmbajtja;
29. Memoriali "Dëshmorët e UÇK-se" Xerxë, Rahovec;
30. Memoriali " i Matirëve Çabrat" Gjakovë;
31. Memoriali "Heroinat" Prishtinë;
32. Memoriali Masakra e Izbicës dhe Rezallës, Skenderaj;
33. Sheshi Memorial "Dr. Ibrahim Rugova" Istog;
34. Shërbimet Inxhinjerike;
35. Ndërtimi i shtatoreve të Zahirrit, Edmondit, Hakifit dhe Ilir Konushevcit në qendër të Podujevës;
36. Restaurimi dhe konservimi i shtëpive muze në lagjen Jashari – Prekaz;
37. Kompleksi Memorial Demë Ahmeti, Podujevë;
38. Ndërtimi i sheshit Hasan Prishtina, Vushtrri;
39. Rregullimi i varrezave në Polac;
40. Mirëmbajtja e Kompleksit Baza e Parë e UÇK-së, Podujevë.

Me respekt.